

1 E hënë, 21 mars 2022

2 [Dëshmia e Viktimës]

3 [Seancë e hapur]

4 [I akuzuari merr pjesë përmes videolidhjes]

5 --- Seanca fillon në orën 11.00 paradite

6 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim]

7 Mirëdita.

8 Zonja Sekretare, ju lutem paraqitni lëndën.

9 SEKRETARJA E SEANCËS: [Përkthim] Mirëdita, të nderuar
10 Gjykatës. Kjo është lënda me numër KSC-BC-2020-05, Prokurori i
11 Specializuar kundër Salih Mustafës.

12 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim]

13 Faleminderit.

14 Pikë së pari, u kërkoj palëve dhe të pranishmëve të
15 prezantohen.

16 Z. Prokuror, na thoni kush është i pranishëm nga Zyra e
17 Prokurorit të Specializuar.

18 Z. MICHALCZUK: [Përkthim] Mirëdita, të nderuar Gjykatës.
19 Mirëdita të gjithëve. Sot përfaqësohemi nga Silvia D'Ascoli,
20 Ndhmësprokurore; Line Pedersen, Menaxhere e Lëndës; dhe nga
21 unë, Cezary Michalczuk, Prokuror.

22 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim]

23 Faleminderit.

24 Mbrojtësja e Viktimave.

25 ZNJ. PUES: [Përkthim] Mirëdita, të gjithëve. Mirëdita, të

1 nderuar Gjykatës. Viktimat pjesëmarrëse në këtë procedurë
2 përfaqësohen sot nga Liesbeth Zegveld, Bashkëmbrojtëse. Dua
3 t'ju prezantoj edhe anëtarën e re të ekipit, Brechtje
4 Vossenberq, pasi anëtarja tjetër ka nisur një karrierë të re,
5 jam dhe unë vetë, Anne Pues. Faleminderit.

6 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim]
7 Faleminderit.

8 Z. avokat i Mbrojtjes keni fjalën.

9 Z. VON BONE: [Përkthim] Mirëdita, të nderuar Gjykatës.
10 Mbrojtja sot përfaqësohet nga unë Julius Von Bone. Nga larg na
11 bashkohet edhe z. Mustafa me videolidhje.

12 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Z.
13 Mustafa, funksionon në rregull lidhja? Na dëgjoni mirë?

14 I AKUZUARI MUSTAJ: [Përmes videolidhjes] Po, znj.
15 Gjykatëse.

16 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Në
17 rregull.

18 Për procesverbalin, ky proces zhvillohet përpara Trupit
19 Gjykues numër I.

20 Gjykatësi Mikula merr pjesë me videolidhje. Pajisja është
21 instaluar që të japë mundësinë që të na ndjekë nga distanca si
22 në seancë publike ashtu edhe në seancë private apo të mbyllur.

23 Sot do të dëgjojmë pikëpamjet dhe shqetësimet e
24 prezantuara nga viktima 05 si edhe parashtrimet e Mbrojtëses
25 së Viktimave. Përpara kësaj, Trupi Gjykues dëshiron që të

1 trajtojë disa aspekte.

2 Znj. Sekretare, ju lutem të kalojmë në seancë private.

3 [Seancë private]

4 [Seancë private teksti i fshirë]

5

6

7

8

9

10

11

12

13

14

15

16

17

18

19

20

21 [Seancë e hapur]

22 SEKRETARJA E SEANCËS: [Përkthim] Të nderuar Gjykatës,

23 jemi në seancë publike.

24 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim]

25 Faleminderit.

1 Javën që shkoi Trupi Gjykues përmes NJAGJ-së mori dy
2 emaile - më datë 11 mars, në orën 10.59 minuta dhe më 17 mars,
3 në orën 12.52 minuta - nga Mbrojtësja e Viktimave, ku ajo
4 ngrinte shqetësime të caktuara sa i takon urdhrit të lëshuar
5 gojarisht nga Trupi Gjykues më datë 9 mars, ku Trupi Gjykues
6 caktonte Institutin Kriminalistik Holandez - që në holandisht
7 quhet NFI - si ekspert për të bërë vlerësim mjekësor të dëmit
8 fizik dhe psikologjik të pësuar nga viktima 8, 9 dhe 10, si
9 pasojë e torturës, të trajtimit mizor dhe ndalimit të
10 arbitruar të pretenduar të cilit i janë nënshtruar për të
11 hartuar një raport brenda datës 13 maj 2022.

12 Duke qenë se Trupi Gjykues i konsideronte këto shqetësime
13 se përbëjnë çështje të rëndësishme materiale, nuk e konsideroi
14 të përshtatshme që t'i jepte sqarimin e kërkuar Mbrojtjes së
15 Viktimave përmes emailit, sidomos duke pasur parasysh që palët
16 e tjera nuk ishin të kopjuar. Në këtë aspekt, Trupi Gjykues i
17 kujton palëve dhe Mbrojtjes së Viktimave që të mos ngrenë
18 çështje materiale me email, vetëm në rastin kur është e
19 domosdoshme.

20 Në përgjigje të emailit të Mbrojtjes së Viktimave, Trupi
21 Gjykues i ka kërkuar që të dorëzojë një parashtrim të
22 protokolluar të premtën që shkoi ose ta ngrejë çështjen në
23 Gjykatë sot. Është dorëzuar ky parashtrim i protokolluar ditën
24 e premte, me numër 346, ku Mbrojtësja e Viktimave i kërkon
25 Trupit Gjykues të sqarojë se cili institut synohet që të

1 caktohet. Dhe, nëse synimi është që të caktohet NFI-ja,
2 Mbrojtësja e Viktimave i kërkon Trupit Gjykses që të rishikojë
3 emërimin duke pasur parasysh parashtrimet e saj me shkrim.

4 Trupi Gjykses gjen se ka themel në argumentet e
5 Mbrojtëses së Viktimave sidomos sa i takon llojit të
6 ekspertizës që ka NFI-ja dhe nevojës për t'ju drejtuar, për
7 shembull, Institutit Holandez të Psikiatrisë dhe Psikologjisë
8 Kriminalistike - në holandisht gjithashtu në NFIP - për një
9 pjesë të konsiderueshme të vlerësimit të kërkuar.

10 Prandaj dhe Trupi Gjykses vendos të rishikojë urdhrin e
11 lëshuar në datë 9 mars 2022 për emërimin e ekspertit dhe të
12 emërojë Institutin Holandez për të Drejtat e Njeriut dhe
13 Ekzaminimin Mjekësor - që i shkurtuar në holandisht është IMMO
14 - për kryerjen e vlerësimit të lartpërmendur.

15 Trupi Gjykses sqaron se objekti i vlerësimit dhe afati
16 për përgatitjen e raportit mbetet i pandryshuar. Trupi Gjykses
17 urdhëron Mbrojtësen e Viktimave gjithashtu që ta përditësojë
18 Trupin Gjykses me një parashtrim të protokolluar në fund të
19 marsit dhe në fund të prillit për ecurinë e vlerësimit të bërë
20 nga eksperti.

21 Këtu mbyllet ky urdhër i lëshuar gojarisht.

22 Urdhri i dytë ka të bëjë me përdorimin e adresave private
23 të postës elektronike në komunikimet e lidhura me procesin
24 gjyqësor. Kemi vënë re shumë herë dhe po kështu edhe javën që
25 shkoi, në komunikimet e dërguara nga Mbrojtja, përdorimin e

1 adresave private të postës elektronike. Trupi Gjykses ju
2 rikujton palëve dhe Mbrojtëses së Viktimave që të përdorin
3 vetëm adresat e emailit të DHSK-së që na është vënë në
4 dispozicion e cila siguron që komunikimi të bëhet siç duhet
5 për sa i takon informacioneve konfidenciale. Trupi Gjykses ju
6 ka dhënë një rikujtesë tjetër për këtë më përpara më datë 22
7 nëntor dhe do preferonim që mos të rikujtonim prapë.

8 Një çështje e tretë ka të bëjë me materialin që do të
9 përdoret me dëshmitarin të mërkurën e ardhshme nga pala
10 thirrëse, pra, nga Mbrojtja. Trupi Gjykses dëshiron t'ju
11 rikujtojë që t'i vendosni në dispozicion Trupit Gjykses,
12 NJAGJ-së dhe palëve jothirrëse një listë përmes postës
13 elektronike të çdo materiali që do të përdorni në pyetjet që
14 do t'i bëni atij dëshmitari, nëse do i bëni pra, sot. Duhet ta
15 kishit bërë javën që shkoi. E vë re që po pohoni me kokë. Ju
16 rikujtoj edhe urdhrin për zhvillimin e procedurës, ku Trupi
17 Gjykses ka bërë të ditur se i duhet vënë në dispozicion një
18 gjë e tillë 10 ditë përpara fillimit të dëshmisë. Dhe çdo
19 kundërshtim ndaj përdorimit të këtyre materialeve duhet të
20 njoftohet me postë elektronike Trupit Gjykses ditës së
21 nesërme. Është më e shkurtër, sigurisht, por na duhet që të
22 kemi edhe ne nevojë [për] kohë që të shikojmë sesi do jenë
23 këto kundërshtime.

24 Në rregull. Po më duket se i kam trajtuar të gjitha
25 aspektet të cilat dëshiroja t'i diskutoja me ju. Mund të

1 kalojmë tani tek objekti kryesor i seancës sot.

2 Znj. Asistente e sallës, ju lutem shoqërojeni viktimën të
3 hyjë në sallë.

4 [Viktima hyn në sallën e gjyqit]

5 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim]

6 VIKTIMA 05: Z. Viktimë, mirëdita. Mirë se keni ardhur në
7 Dhomat e Specializuara.

8 VIKTIMA 05: Mirë se ju gjetëm.

9 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Më
10 dëgjoni?

11 VIKTIMA 05: Po, po.

12 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Pikë
13 së pari, si jeni?

14 VIKTIMA 05: Mirë. Faleminderit.

15 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim]

16 Përpara se të filloni të prezantoni mendimet dhe shqetësimet
17 tuaja, kam disa gjëra për t'ju thënë.

18 VIKTIMA 05: Veç urdhnoni.

19 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Pikë
20 së pari, dua të shpjegoj masat mbrojtëse që janë miratuar për
21 praninë tuaj në sallën e gjyqit.

22 Identiteti juaj nuk do t'i zbulohet publikut të
23 përgjithshëm. Do të thotë që asnjëherë nuk do t'ju përmendim
24 emrin, por gjithmonë do t'ju quajmë si z. Viktimë, në mënyrë
25 që publiku mos t'ju marrë vesh emrin. Gjithashtu prania juaj

1 këtu është me shtrembërim të fytyrës dhe të zërit, e kjo do të
2 thotë se askush jashtë kësaj salle që e ndjek, që e përcjell
3 transmetimin nuk jua shikon dot fytyrën apo nuk -- edhe nuk
4 jua dëgjon dot zërin. Kur të përshkruani diçka e cila në
5 veçanti ka lidhje me ju personalisht apo nëse do të përmendni
6 fakte të cilat mund t'jua zbulojnë identitetin, këtë do t'jua
7 bëjmë në seancë private, kjo do të thotë që nuk do të ketë
8 transmetim, pra, askush jashtë kësaj salle nuk mund ta
9 përcjellë atë që do thuhet këtu.

10 Nëse do të thuhet diçka në seancë të hapur e cila mund
11 t'ju identifikojë, këtë informacion ne mund ta mbrojmë. Do ta
12 mbrojmë. Siç do ta shihni sot seanca do të transmetohet me
13 vonesë, kjo na jep mundësi që të heqim informacione të tilla
14 nga transmetimi që do të shikojë dhe do të dëgjojë publiku, po
15 kështu edhe nga transkripti, nga procesverbali publik i
16 procedurës.

17 Krahas këtyre masave mbrojtëse, Trupi Gjykses më datë 18
18 mars 2022, pra - të premtën - ka miratuar, pra, Trupi Gjykses
19 ka miratuar dhe një masë tjetër shtesë me kërkesë të Zyrës së
20 Mbrojtjes dhe Mbështetjes së Dëshmitarëve, në përputhje me
21 rregullin 80(4)(c)(i) dhe (5) të Rregullores, kjo masë e
22 veçantë është prania e psikologes gjatë dëshmisë tuaj këtu.
23 Vendimi i Trupit Gjykses u është bërë i ditur përmes Njesisë
24 së Administrimit Gjyqësor palëve dhe Mbrojtëses së Viktimave
25 me postë elektronike më datë 18 mars 2022, në orën 21.28

1 minuta, pra, ditën e premte.

2 Për procesverbalin, e përmend që këtu është edhe
3 psikologja e pranishme.

4 Z. Viktimë, a janë të qarta masat mbrojtëse që sapo jua
5 shpjegova?

6 VIKTIMA 05: Po, të qarta janë. Po.

7 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim]
8 Faleminderit.

9 Z. Viktimë, këtu jeni thirrur sot që të prezantoni
10 mendimet dhe shqetësimet tuaj përpara Dhomave të Specializuara
11 në çështjen gjyqësore Prokurori i Specializuar kundër Salih
12 Mustafës. Dëshiroj të theksoj, z. Viktimë, se Trupi Gjykses ju
13 kërkon që të mos përsëritni ato që i keni thënë më përpara në
14 deklaratën që ia keni dhënë ZPS-së. Këto janë pranuar tashmë
15 në prova gjyqësore. Do t'ju lutesha që të përqendrohëni, të
16 fokusoheni dhe të na tregoni vetëm pikëpamjet dhe shqetësimet
17 që shkojnë përtej, pra, që nuk kanë bërë pjesë në atë që keni
18 thënë në pyetjet që jua ka bërë ZPS-ja.

19 Shoh që Mbrojtësja e Viktimave është ngritur në këmbë.

20 ZNJ. PUES: [Përkthim] Po, mund ta përfundoni këtë pjesë.
21 Por siç është komunikuar përpara, z. Viktimë do të prezantojë
22 mendimet e tij apo shqetësimet e tij, po në fillim do të mbaj
23 unë një fjalë, do t'i drejtohem Trupit Gjykses, pastaj do të
24 drejtohet z. Viktima.

25 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim]

1 Patjetër. Patjetër. Do t'jua jap unë fjalën më vonë. Nuk ju
2 kemi harruar, por ju falënderojmë që na e kujtuat.

3 Pra, ajo që do thoni ju nuk do të jetë objekt [i]
4 pyetjeve, me një fjalë, nuk do t'ju bëjnë më pyetje as palët,
5 as Mbrojtësja e Viktimave dhe fjala juaj këtu nuk do të
6 konsiderohet si provë nga Trupi Gjykues, përveç rastit kur
7 Trupi Gjykues e konsideron të domosdoshme që t'ju thërrasë si
8 dëshmitar sipas rregullit 132 të Rregullores.

9 Por në fillim dua që t'ju jap disa këshilla praktike.

10 Z. Viktimë, të gjitha gjërat që ne themi këtu, përkthehen
11 dhe regjistrohen, është e rëndësishme që të flisni afër
12 mikrofonit, që e keni përpara, të flisni qartë dhe të flisni
13 ngadalë. Sepse kjo u jep mundësi përkthyesve që të përkthejnë
14 gjithçka. Duhet filloni të flisni vetëm atëherë kur personi që
15 ju drejtohet e ka mbaruar fjalën e vet. Pra, numëroni deri në
16 pesë me vete sepse kjo pauzë u jep mundësi përkthyesve që ta
17 bëjnë punën e tyre siç duhet, të përkthejnë gjithçka.

18 Në se keni pyetje, nëse keni nevojë për pauzë, nëse keni
19 nevojë për ndihmë, mjafton ta ngrini dorën dhe unë do t'jua
20 jap fjalën dhe pastaj mund të thoni atë që dëshironi të thoni.

21 I kuptuat të gjitha këto, z. Viktimë?

22 VIKTIMA 05: Po. Po, në rregull është.

23 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim]

24 Përpara se të fillojmë, Trupi Gjykues i ka dhënë leje
25 Mbrojtëses së Viktimave që të bëjë parashtime përpara dhe/ose

1 pasi z. Viktimë ka prezantuar mendimet dhe shqetësimet e tij
2 për jo më shumë se një orë.

3 Rrjedhimisht do e pyes Mbrojtësen e Viktimave nëse synon
4 që të bëjë ndonjë parashtrim tani dhe, nëse po, dëshironi ta
5 bëni në seancë publike apo seancë private.

6 ZNJ. PUES: [Përkthim] Faleminderit, e nderuar Gjykatëse.

7 Do të bëj një parashtrim tani përpara se viktima t'i
8 drejtohet Trupit Gjykues dhe këtë do ta bëj në seancë publike
9 në mënyrë që të vijojmë kështu. Pra, mund ta bëjmë këtë gjë. E
10 kam parë deklaratën dhe besoj se mund ta bëjmë kështu.

11 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Mirë
12 atëherë e keni ju fjalën, avokatja e viktimave.

13 ZNJ. PUES: [Përkthim] Faleminderit shumë.

14 Edhe njëherë mirëdita, të nderuar Gjykatës. Mirëdita të
15 gjithëve.

16 Mirëdita, z. Viktimë, gjithashtu.

17 E sotmja është një ditë ku u jepet mundësi viktimave të
18 japin mendime shtesë. Dhe që në fillim të këtij gjykimi, neve
19 kemi parashtruar disa pika kryesore të cilat parashtrojnë
20 pikat kryesore që kanë të bëjnë me viktimat të cilat janë
21 pjesëmarrës në këtë proces gjyqësor. Ne po ashtu përfitojmë
22 nga rasti që të kontribuojmë për gjetjen e së drejtës dhe të
23 vërtetës nga Trupi Gjykues dhe këtë do të mundohemi ta
24 realizojmë përmes kësaj seance të ditës së sotme fillimisht
25 duke bërë pyetje dhe gjithashtu edhe duke dhënë kontributin

1 tonë.

2 Në seancën e ditës së sotme, do të bëjmë si më poshtë.

3 Së pari, unë, si Avokate e Viktimave, do të trajtoj disa
4 çështje të cilat janë të rëndësishme për viktimat pjesëmarrëse
5 në këtë proces gjyqësor. Më pas, viktima e autorizuar nga
6 Trupi Gjykses do të parashtrojë pikëpamjet apo shqetësimet e
7 veta të cilat plotësojnë deklaratën që ka dhënë për
8 Prokurorinë dhe, siç e keni shpjeguar dhe ju, e nderuar
9 Gjykatëse, janë pranuar në prova materiale.

10 Për ata që e përcjellin këtë proces, mbase dhe nga larg,
11 mbase do të jetë me vlerë që të dinë, siç e theksove dhe pak
12 momente më përpara, që ne do të flasim, domethënë, fjala ime
13 do të jetë tërësisht në seancë publike. Pikëpamjet e
14 paraqitura nga viktima pjesëmarrëse në pjesën më të madhe do
15 të duhet të paraqiten në seancë private, sepse është thujse e
16 pamundur të veçohen informacionet identifikuese nga fjalët e
17 thëna. Prandaj edhe gjatë asaj kohe publiku nuk mund t'i
18 përcjellë këto konstatime, këto fjalë të tij. Megjithatë,
19 viktima do të mbarojë ndërhyrjen e vet me disa fjalë më të
20 përgjithshme të cilat mund dhe do të transmetohen në seancë të
21 hapur dhe unë do të jap indikacionet përkatëse kur seanca do
22 të jetë e hapur dhe kur do të jetë e mbyllur dhe qëllimi
23 kryesor është që t'i jepet mundësi publikut të kuptojë deri
24 diku pikëpamjet dhe shqetësimet e paraqitura.

25 Të nderuar Gjykatës, gjatë paraqitjes nga Prokuroria, ju

1 keni dëgjuar vetë viktimat e drejtpërdrejta dhe të tërthorta
2 të flasin për përvojën dhe vuajtjet e tyre. Si dëshmitar, ata
3 kanë dhënë informacione të drejtpërdrejta lidhur me krimet që
4 kanë përjetuar dhe për mënyrën sesi ato kanë pasur ndikim mbi
5 jetën e tyre.

6 Për ata që e përcjellin këtë proces gjyqësor nga larg,
7 për publikun, që mbase po dëgjon dhe i shikon këto procedura
8 nga Kosova, përmes shërbimit të transmetimit të drejtpërdrejtë
9 që ofron kjo Gjykatë, dua të them sa poshtë. Është e thellë
10 brengosja që pjesë të mëdha të Prokurorisë është dashur të
11 paraqiten në seancë private, pa i dhënë mundësi publikut t'i
12 përcjellë këto procedura dhe padëgjuar plotësisht këto
13 parashtrime. Kemi dëgjuar sesi janë përshkruar këtu akte
14 torturash, kemi parë sesa të tronditur kanë qenë dëshmitarët
15 për shkak të tyre dhe këtyre dëshmitarëve u është dashur që
16 t'i rikujtojnë dhe t'i përjetojnë dhe njëherë këto ngjarje.
17 Kemi dëgjuar dëshmitarët të përshkruajnë gjendjen, për
18 shembull, të një kufome, të një njeriu të vrarë me muaj të
19 tërë pas vdekjes së tij.

20 Ky ishte një njeri i dashur për shumë vetë. Kemi parë
21 fotografi të kufomës dhe kemi dëgjuar shumë dëshmitarë sesi
22 kanë përshkruar me hollësi sa keq u trajtua ky njeri, sesi ai
23 ka qenë më shumë i vdekur sesa i gjallë ndërkohë që është
24 mbajtur në Zllash nga njësitë BIA.

25 Viktimat e kuptojnë se përvoja e tyre nuk janë ngjarje të

1 veçuar. Lufta dhe përpjekja e Kosovës ka marrë shumë jetë.
2 Për viktimat pjesëmarrëse këtu, është e rëndësishme të
3 theksohet se ata janë pjesë e kësaj të shkuare, të tashmes dhe
4 gjithashtu edhe të ardhmes së Kosovës.

5 Ajo që ata duan është që të njihet ajo çfarë ka ndodhur,
6 të kuptohet ajo, si dhe të jenë në gjendje që të thyejnë
7 heshtjen.

8 Unë kam folur për këtë gjë gjatë e gjerë në deklaratën
9 time hyrëse. Arsyeja sepse e ritheksoj këtë element këtu është
10 se e kuptoj se perspektiva e viktimave në përgjithësi i
11 fshihet publikut për shkak të nevojës për mbrojtje. Ata që na
12 kanë përcjellë rregullisht e njohin shumë mirë tashmë shenjën
13 "seancë private" në ekran. Pas kësaj shenje "seancë private"
14 fshihen histori dhimbjeje, humbjeje dhe traume. Dhe e kemi me
15 merak që këto të jenë informacione të ditura publikisht.

16 Viktimat pjesëmarrëse në proces kanë ndjerë tensionin dhe
17 stresin e përjetimit të kujtimeve të ngjarjeve të vitit 1999.
18 Gjithashtu, edhe stresi i paraqitjes përpara të nderuarve
19 Gjykatës dhe i përballimit të pyetjeve rigorozë, por edhe e
20 kanë kuptuar se këto pyetje janë pjesë e domosdoshme e
21 drejtësisë, siç kanë kuptuar gjithashtu edhe nevojën për
22 gjykimin e drejtë.

23 Në emër të viktimave që janë paraqitur përpara këtij
24 Trupi Gjykses, dëshiroj t'ju jap një fjalë falënderimi sepse
25 ata e kanë ndjerë se kanë marrë mbështetjen e rëndësishme prej

1 atyre që punojnë në këtë Gjykatë, shpesh pa u ndjerë dhe
2 shpesh prapa kuintave dhe në role të ndryshme.

3 Është e rëndësishme që secili prej tyre të ketë hapësirë
4 të tregojë, jo vetëm historinë e vet, por edhe të ndjejë se
5 kjo histori kontribuon në përpjekjet e Trupit Gjykues për të
6 gjetur të vërtetën. Ky është për të gjithë ata në fakt aspekti
7 më i rëndësishëm, pra, e vërteta është aspekti më i
8 rëndësishëm.

9 Këto viktime kanë përjetuar një periudhë të vështirë
10 emocionale gjatë muajve të fundit. Stresi dhe frika, në pritje
11 të asaj çfarë mund të sjelli gjykimi, emocione të forta gjatë
12 përjetimit edhe njëherë të së shkuarës së tyre dhe kujtimi i
13 sa më shumë hollësive që ato mundeshit gjatë dhënies së
14 dëshmisë përpara Trupit Gjykues. Ata kanë përjetuar dhe
15 ndjenja pozitive gjatë dëshmisë sepse më në fund u është
16 dëgjuar zëri. Por, gjithsesi, jo pa frikë dhe pa merak.

17 Sipas mendimit tonë, është e rëndësishme t'i bëhen të
18 ditura këto larmi emocionesh dhe stresi përpara Trupit
19 Gjykues, të gjithë të pranishmëve këtu në këtë proces gjyqësor
20 dhe atyre që na dëgjojnë nga larg. Askush prej tyre nuk e ka
21 marrë me mendjelehtësi vendimin për të luajtur një rol aktiv
22 në këtë proces, askush prej tyre. Askush prej tyre nuk ka
23 dashur t'i përjetojë edhe njëherë këto ndjesi. E megjithatë e
24 kanë bërë këtë gjë për të dhënë kontributin e tyre për gjetjen
25 e të vërtetës dhe për arritjen e drejtësisë.

1 Ne dëshirojmë edhe të pranojmë, të njohim, të
2 nënvijëzojmë përpjekjet e Trupit Gjykses për të realizuar të
3 drejtat që kanë viktimat në të drejtën ndërkombëtare. Jo vetëm
4 të drejtat për të vërtetën dhe drejtësinë por edhe të drejtën
5 për zhdëmtim lidhur me dëmin që kanë pësuar dhe dëmin e bërë.

6 Trupi Gjykses ka vendosur tashmë të mos i referojë
7 viktimat në proceset civile përpara gjykatave të tjera të
8 Kosovës sa i takon çështjes së zhdëmtimit. Kjo do të thotë, të
9 nderuar Gjykatës, që në aktgjykimin tuaj, ju mund të përfshini
10 edhe vendim për dëm, për humbje dhe lëndimin në lidhje me
11 viktimat. Edhe në rast të shpalljes fajtor, mund të jepni
12 urdhër drejtpërdrejtë të akuzuarit në mënyrë që të marrë
13 zhdëmtimin e përshtatshëm.

14 Procesi i zhdëmtimit zhvillohet veçmas nga proces penal
15 megjithëse është i gërshetuar me procesin penal, duke çuar
16 eventualisht në një urdhër zhdëmtimi në pajtim me nenin 22(8)
17 dhe nenin 44(6) të Ligjit të kësaj Gjykate. Këtë Trupi Gjykses
18 e ka bërë të qartë. Është bërë i qartë për ju, të nderuar
19 Gjykatës, në vendimin tuaj për të drejta procedurale të
20 viktimave gjatë gjyimit të datës 12 korrik 2021.

21 Këto procese bien brenda objektit të nenit 6(1) të
22 Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut. Viktimat gëzojnë
23 të drejta procedurale sipas këtij neni në lidhje me kërkesat
24 për zhdëmtim dhe sigurisht, që këtu përfshihet e drejta për të
25 parashtruar vërejtje apo prova që viktimat i konsiderojnë me

1 rëndësi për të mbështetur kërkesat e tyre për zhdëmtim.

2 Ne do të shfrytëzojmë rastin tonë sot për të parashtruar
3 sesi e shohim zhvillimin e mëtejshëm të rastit të zhdëmtimeve
4 për viktimat.

5 Ne kemi kërkuar që më parë caktimin e një eksperti
6 mjekësor për të bërë vlerësimin e dëmit fizik dhe psikologjik
7 që kanë pësuar viktimat e drejtpërdrejta. Dhe në urdhrin e
8 lëshuar gojarisht më 9 mars 2020, kombinuar po ashtu edhe me
9 urdhrin e dhënë gojarisht sot, Trupi Gjykses ka caktuar një
10 ekspert. Ky urdhër do të zbatohet gjatë muajve në vijim.

11 Gjatë seancës gjyqësore të datës 8 mars 2020, Trupi
12 Gjykses e pyeti Mbrojtësen e Viktimave nëse po mendojmë të
13 kërkojmë caktimin e një eksperti që mund të ndihmojë për
14 përcaktimin e dëmshpërblimit që duhet urdhëruar. Trupi Gjykses
15 bëri të ditur se përgjigja nuk i duhej në këtë pikë kohe, por
16 do të donte të parashikonte se çfarë mund të pritej për fazat
17 që mund të vinin më pas.

18 Shfrytëzoj rastin sot t'ju jap disa sqarime të mëtejshme
19 lidhur me pikëpamjet tona mbi këtë pikë. Ne do të dorëzojmë,
20 në momentin e duhur, një parashtrim më vete mbi dëmshpërblimin
21 sesi duhet llogaritur ai sipas pikëpamjes tonë ose si duhet
22 vlerësuar ai nëse do të ketë një vendim shpallje fajtori. Por
23 për t'i ndihmuar të gjitha palët dhe Trupin Gjykses për të
24 bërë planet dhe parashtrimet e tyre, ne do të japim një
25 përshkrim të mendimeve dhe planeve tona lidhur më këtë tani.

1 Sa i takon dëmit material, do t'i kërkojmë Trupit Gjykses
2 e një ekspert për llogaritjen e dëmit material. Të gjitha
3 viktimat e drejtpërdrejta kanë pësuar dëm material. Ne duhet
4 të mendojmë humbjen e aftësisë për të punuar dhe ndikimin që
5 kanë lënë lëndimet psikologjike dhe fizike në të ardhurat e
6 tyre dhe në zhvillimin e tyre profesional. Normalisht, një
7 vendim i Gjykatës do të pasqyrojë shumën e plotë të
8 llogaritur të dëmit material. Edhe kjo është arsyeja pse
9 besojmë se duhet caktuar një ekspert në mënyrë që të ndihmojë
10 për të llogaritur një dëm faktik material të tillë, në veçanti
11 në kontekstin shumë kompleks të situatës së pasluftës.

12 Dëmi jomaterial nuk është i lehtë për t'u llogaritur. Të
13 gjitha viktimat e drejtpërdrejta kanë përjetuar torturë ose
14 trajtim çnjerëzor, duke u lënë atyre dëmtime të përhershme
15 fizike dhe mendore. Gjithashtu dhe ndalimi arbitrar ka lënë
16 shenjat e veta mendore. Ne mendojmë se ky dëm jomaterial duhet
17 vlerësuar në baza të drejta.

18 Ne do t'i kërkojmë Trupit Gjykses të bëjë një vlerësim në
19 baza të drejta, duke mbajtur parasysh deklaratat e vetë
20 viktimave, raportin e ekspertit mjekësor, si edhe standardet
21 që burojnë nga jurisprudenca ndërkombëtare dhe kombëtare. Në
22 një parashtrim që do të paraqitet në një datë të mëvonshme, ne
23 do të japim në hollësi jurisprudencën ku duhet të mbështetet
24 Trupi Gjykses dhe që mund ta ndihmojë Trupin Gjykses në
25 urdhrin për zhdëmtimin, duke sugjeruar edhe mundësitë në

1 lidhje me zhdëmtimet e përshtatshme të veçanta lidhur me dëmin
2 jo material.

3 Shpresoj që këto pika ta ndihmojnë Trupin Gjykses të
4 planifikojë paraprakisht për ta çuar përpara me shpejtësi
5 procesin, çfarë përbën, sipas mendimit tim, edhe interesin e
6 të gjithëve.

7 Së fundi, ne i mirëpresim përpjekjet e Trupit Gjykses për
8 të siguruar që në fund procesi gjyqësor të dalë me rezultat të
9 prekshëm. Në këtë kuadër, përmendim kërkesën e Trupit Gjykses
10 drejtuar qeverisë së Kosovës dhe përgjigjen më të fundit prej
11 saj. Edhe pse kjo përgjigje do të kërkojë një analizë më të
12 hollësishme, theksojmë këtu, se disa pika mbeten të hapura siç
13 është, për shembull, zbatueshmëria e legjislacionit të cituar
14 në një situatë përpara se të ekzistonte Republika e Kosovës,
15 pra, përpara sesa të ekzistonte kjo si subjekt, pra, siç i
16 referohet tërësia e legjislacionit. Pra, po kështu nuk kanë
17 marrë zgjidhje plotësisht problemet të tjera, si nevoja për
18 vijimësi të anonimitetit. Pra, kjo është një çështje e cila po
19 ashtu nuk është trajtuar plotësisht.

20 Siç e kam thënë më parë, do të ofrojmë mendimet tona të
21 mëtejshme lidhur me këtë pikë në momentin e duhur. Por ajo
22 çfarë duam të pranojmë dhe të vlerësojmë është se në këtë
23 aspekt përpjekjet e Trupit Gjykses kanë qenë të lëvdueshme dhe
24 ne shpresojmë që qeveria të mund të heqë çdo ambiguitet, çdo
25 dyshim dhe të sigurojë një qasje konstruktive që do t'u lejojë

1 viktimave që të mund të përmbushin pretendimet e tyre për
2 zhdëmtim.

3 Me këto pika, dëshiroj ta mbyll fjalën time si Mbrojtëse
4 e Viktimave sot.

5 Z. Viktimë është këtu i pranishëm dhe është i gatshëm që
6 të japë shqetësimet e tij, pikëpamjet e tij në mënyrë të
7 drejtpërdrejtë dhe për këtë, siç e thashë edhe më përpara, ju
8 sugjeroj të kalojmë në seancë private, duke qenë se deklarata
9 përmban shumë informacione personale të cilat mund të cenojnë
10 masa mbrojtëse të miratuara nga Trupi Gjykses. Por, siç e
11 përmenda dhe në fillim, pjesa e fundit e deklaratës së
12 viktimës do të mbahet në seancë publike dhe unë do t'i tregoj
13 Trupit Gjykses se kur ka ardhur momenti për seancë publike.

14 Ju faleminderit për vëmendjen.

15 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Shumë
16 faleminderit, Mbrojtëse e Viktimave.

17 Tani mund të vazhdojmë me pikëpamjet dhe me shqetësimet e
18 viktimës.

19 Paneli i ka caktuar një orë në dispozicion viktimës në
20 mënyrë që të shprehë pikëpamjet dhe shqetësimet e veta dhe
21 gjithashtu që të tregojë një fotografi që është ndarë me palët
22 dhe me Trupin Gjykses nga Mbrojtësja e Viktimës, si një
23 bashkëlidhje e një dosjeje të protokolluar që është dërguar të
24 premtën e shkuar, që është dosja e protokolluar me numrin 352.

25 Mirë, atëherë.

1 Z. Viktimë, tani do të kalojmë në seancë private dhe
2 pasi të kalojmë në seancë private, do t'ju jap fjalën në
3 mënyrë që të mund të ndani me ne shqetësimet dhe pikëpamjet
4 tuaja.

5 Znj. Sekretare, ju lutem na kaloni në seancë private.

6 [Seancë private]

7 [Seancë private teksti i fshirë]

8

9

10

11

12

13

14

15

16

17

18

19

20

21

22

23

24

25

1 [Seancë private teksti i fshirë]

2

3

4

5

6

7

8

9

10

11

12

13

14

15

16

17

18

19

20

21

22

23

24

25

1 [Seancë private teksti i fshirë]

2

3

4

5

6

7

8

9

10

11

12

13

14

15

16

17

18

19

20

21

22

23

24

25

1 [Seancë private teksti i fshirë]

2

3

4

5

6

7

8

9

10

11

12

13

14

15

16

17

18

19

20

21

22

23

24

25

1 [Seancë private teksti i fshirë]

2

3

4

5

6

7

8

9

10

11

12

13

14

15

16

17

18

19

20 [Seancë e hapur]

21 SEKRETARJA E SEANCËS: [Përkthim] Të nderuar Gjykatës,

22 jemi në seancë publike.

23 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim]

24 Faleminderit, znj. Sekretare.

25 Z. Viktimë, tani jemi në seancë publike. Keni sërish

1 fjalën, mund të vazhdoni.

2 VIKTIMA 05: Si viktimë pjesëmarrëse në këtë gjykim, e
3 pata rastin me fol shumë për [REDAKTUAR]. Kemi heshtur për
4 këto vite prej frikës, [REDAKTUAR]
5 [REDAKTUAR]

6 Mendimet edhe lutjet e mia janë me familjet që kanë anëtarë të
7 familjes të zhdukur.

8 Na eventualisht e kemi gjetur [REDAKTUAR].

9 [REDAKTUAR] Po muj me
10 imagjinu sesa zor është nëse nuk dinë se ç'ka i ka ndodhur
11 [REDAKTUAR]

12 [REDAKTUAR] Është me rëndësi me e mbaj të këtë në mend. Dhe po du
13 me thënë, që mendja dhe zemrat tona janë me këto familje.

14 Në fund, po du me thënë, që shpresoj që një ditë të
15 gjithë i kemi me qenë të lirë me fol për përjetimet tona. Po
16 shpresoj për një të ardhme pa krime, pa vrasje, pa frikë.

17 Krejt çka po kërkoj është liria. Ne dojmë shtetin tonë,
18 Kosovën dhe nuk jemi tuj dashtë me thënë kurr gjë të keqe. Por
19 po kërkoj me qenë i lirë me tregu ça kemi përjetu pa pasë
20 frikë. Po shpresoj që një ditë kemi me mujtë.

21 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim]

22 Faleminderit, z. Viktimë.

23 Mbrojtësja e Viktimave, keni diçka për të parashtruar më
24 tej?

25 ZNJ. PUES: [Përkthim] Jo, e nderuar Gjykatëse, nuk kemi

1 gjëra të tjera për të thënë. Besoj se këto fjalë flasin vetë
2 s'kanë më nevojë për gjë tjetër.

3 Falënderojmë dhe z. Viktimë, për fjalën e tij.

4 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Z.
5 Viktimë, kemi mbaruar së dëgjuari pikëpamjet dhe shqetësimet
6 tuaja, si dhe parashtrimet e Mbrojtëses së Viktimave.

7 Ju falënderoj për kohën. Ma merr mendja duhet të ketë
8 qenë e vështirë dhe dëshiroj t'ju falënderoj sepse besoj se
9 ajo që na treguat këtu sot do të na ndihmojë në punën tonë si
10 Trupi Gjykses për të gjetur të vërtetën.

11 Ju falënderoj shumë.

12 VIKTIMA 05: Faleminderit ju.

13 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Të
14 urojmë një udhëtim të mbarë në kthim. Dhe ju rikujtoj që të
15 mos ta bisedoni me askënd ato të cilat i keni thënë këtu
16 përpara Dhomave të Specializuara të Kosovës.

17 Znj. Asistente e sallës, ju lutem shoqëroheni dëshmitarin
18 që të dalë nga salla.

19 Do t'ju shoqërojnë tani të dilni nga salla.

20 [Viktima largohet]

21 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim]

22 Faleminderit, znj. Asistente e sallës.

23 Përpara se të ndërpresim seancën sot, dua t'u drejtohem
24 të pranishmëve për të pyetur nëse kanë diçka të cilën
25 dëshirojnë ta ngrenë përpara Trupit Gjykses, përpara se të

1 takohemi nesër.

2 Z. Prokuror, keni diçka për të ngritur?

3 Z. MICHALCZUK: [Përkthim] Asgjë, e nderuar Gjykatëse.

4 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim]

5 Mbrojtësja e Viktimave?

6 ZNJ. PUES: [Përkthim] Asgjë dhe nga ana jonë.

7 Faleminderit.

8 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Z.

9 avokat i mbrojtjes, keni diçka për të ngritur përpara Trupit
10 Gjykues?

11 Z. VON BONE: [Përkthim] Po, e nderuar Gjykatëse, kam një
12 pyetje.

13 Urdhri më i fundit që Trupi Gjykues ia ka dhënë Mbrojtjes
14 sa i takon shtimit të një personi në listë.

15 Po. Ai urdhër thoshte se duhej që të dorëzoja për
16 procesverbalin në çështjen gjyqësore që janë të disponueshëm
17 për ZPS-në dhe Zyrën Administrative. Thjesht për të qenë i
18 qartë, do të thotë që Mbrojtësja e Viktimave nuk do të
19 kopjohet në këtë?

20 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Jo.
21 Jo në një moment të mëparshëm. Por është mirë që e sqaruat.

22 Z. VON BONE: [Përkthim] Sepse ishte një pyetje edhe
23 [bërë] NJAGJ-së lidhur me këtë por do ta ridorëzojmë, kjo
24 është arsyeja. E kam bërë të shtunën, por do ta bëj dhe sot.
25 Do të shkruaj "konfidencial *ex parte*"

1 Kaq kisha. Faleminderit shumë.

2 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim]

3 Faleminderit.

4 Nëse palët dhe pjesëmarrësit nuk kanë asgjë tjetër për të
5 ngritur, do të rifillojmë nesër në orën 9.30.

6 Falënderoj palët dhe Mbrojtësen e Viktimave për praninë.
7 Falënderoj përkthyesit, stenografin, teknikët audiovizivë
8 dhe personelin e sigurisë.

9 Do të rifillojmë nesër në orën 9.30.

10 --- Seanca përfundon në orën 12.09

11

12

13

14

15

16

17

18

19

20

21

22

23

24

25